

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FAKULTETI JURIDIK
Titulli i lëndës:	E DREJTA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS (<u>kjo lëndë është ndryshuar në emërtim dhe përmbajtje sipas rekomandimit të ekspertëve të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës</u>).
Niveli:	BACHELOR
Statusi lëndës:	OBLIGATIVE
Viti i studimeve:	3 + 2 (Semestri veror)
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	8
Koha / lokacioni:	Salla S2
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.Dr.Arsim Bajrami & Prof.Dr.Murat Jashari
Detajet kontaktuese:	arsim_bajrami@hotmail.com , murat.jashari@uni-pr.edu , florentmuqaj@gmail.com , fortuna.haxhikadrija@gmail.com
Përshkrimi i lëndës	<p>Lënda E DREJTA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS ka për objekt studimi aspektin historik dhe pozitiv të së drejtës kushtetuese të Republikës së Kosovës. Kjo lënë e cila ligjërohet në semestrin e fundit të studimeve themelore ka në fushëveprim të studimit sistemin historik dhe normativ kushtetues që është i zbatueshëm në Republikën e Kosovës. Megjithëse kjo lëndë mund të duket e ngjashme me objektin e studimit të lëndës e drejta kushtetuese aktuale, e cila ligjërohet në studimet master, mirëpo leht mund te verehet se qasja e trajtimit të objektit të studimit në mes të kësaj dhe lëndës e drejta kushtetuese e Republikës së Kosovës është e ndryshme, në kuptim të asaj që trajtohet.</p> <p>Lënda e drejta kushtetuese e Republikës së Kosovës ka një qasje të thelluar të të drejtës kushtetuese të aplikueshme në Kosovë, prandaj edhe i ofrohet studentëve që zgjedhin me theks të veçantë modulin kushtetues administrativ.</p>
Qëllimet e lëndës:	Kjo lëndë ka për qëllim që të familjarizoj studentët e studimeve bachelor me pjesën teorike të së drejtës kushtetuese të Republikës së Kosovës si degë e re e së drejtës kushtetuese në përgjithësi. Në kuadër të kësaj lënde, studentët do të përfitojnë njohuri të detajuara të funksionimit të rendit kushtetues të Republikës së

	<p><i>Kosovës, duke filluar nga kushtetuta si akti më i lartë juridik, përfshirë këtu edhe kontekstin politik të krijimit të shtetit të Kosovës dhe karakteristikat që kanë veçuar rrugën mbi bazën e të cilës është krijuar Republika e Kosovës. Përpos kësaj, studentët do të fitojnë njohuri për funksionimin e institucioneve kushtetuese në Republikën e Kosovës, siç janë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, Presidenti, sistemi i drejtësisë në Republikën e Kosovës si dhe institucionet e tjera kushtetuese relevante.</i></p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Fiton njohuri të detajuara për sistemin kushtetues në Kosovë; 2. Mësojnë për raportin e pushteteve në sistemin kushtetues të Kosovës; 3. Mësojnë për funksionimin e institucioneve kushtetuese të Kosovës, 4. Fiton njohuri për praktikën institucionale kushtetuese në Republikën e Kosovës 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënës të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	1/14	42
Ushtrime teorike/laboratorike	2	1/14	28
Punë praktike	2	1/14	14
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	3	1/14	42
Ushtrime në teren	1	1/1	1
Kollokfiime,seminare	3	3/3	9
Detyra të shtëpisë	2	1/10	20
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	1/15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	1/15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	3	1/1	3
Projektet,prezentimet ,etj	2	1/4	8
Totali			227
Metodologjia e mësimdhënies:	<p><i>Metodologjia e mësimdhënies në lëndën E Drejta Kushtetuese e Republikës së Kosovës do mbështetet në aplikimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies siç janë zbatimi i metodave interaktive të</i></p>		

	<p>mësimdhënies, puna ne grupe dhe përfshirja e studentëve në punime me shkrim, aplikimi i prezantimeve vizuele të materialeve si dhe simulimi i rasteve studimore si formë e suksesshme e punës praktike me studentë. Në veçanti studentët do të kenë mundësinë e angazhimit në procesin e funksionimit praktik të institucioneve kushtetuese përmes vizitave në këto institucione, me theks të veçantë vizita në kuvendin e Republikës së Kosovës dhe institucionet e tjera.</p>
Metodat e vlerësimit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësimi i parë: 30% 2. Vlerësimi i dytë 25% 3. Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% 4. Vijimi i rregullt 5% 5. Provimi final 30% 6. Total 100%
Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Prof.Dr.Arsim Bajrami, <i>Sistemi Kushtetues i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2011;</i> 2. Prof.Dr.sc.Arsim Bajrami, <i>Parlamentarizmi (aspekte krahasuese), Kolegji Fama, Prishtinë, 2010;</i> 3. Prof.Dr.Arsim Bajrami, <i>Draftimi i Kushtetutës, Prishtinë, 2007;</i> 4. <i>Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008</i> 5. <i>Rregullorja e Punës së Kuvendit, 2010;</i> 6. <i>Rregullorja e punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës;</i> 7. <i>Ligji për presidentin e Republikës së Kosovës;</i> 8. <i>Ligji Për Gjykatën Kushtetuese;</i>
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Luan Omari, <i>“Kushtetuta e Republikës së Kosovës, një Vështrim Krahasues”, Tiranë 2009;</i> 2. Noel Molcolm, <i>“Kosovo-a Short History”, Macmillan, London 1998;</i> 3. Arsim Bajrami, Migena Leskoviku, Zemri Elezi, Florent Muqaj <i>“Imuniteti-Aspekte Krahasimore”, Prishtinë 2013;</i> 4. Arsim Bajrami, Zenun Halili, Jusuf Zejneli, Florent Muqaj, <i>“Pozita Kushtetuese dhe Ligjore e Pakicave Kombëtare-aspekte krahasuese”;</i> 5. Joseph Marko, <i>“The New Kosovo Constitution in a Regional Comparative Perspective”, Review of Central and East European Law;</i>

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Hyrje	Njoftimi me programin dhe metodat e punës
Java e dytë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Burimet e të Drejtës Kushtetuese në Republikën e Kosovës
Java e tretë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Historia kushtetuese e Republikës së Kosovës
Java e katërt:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pozita Kushtetues e Kosovës në kuadër të ish-Jugosllavisë 2. Suprimimi (heqja) e autonomisë kushtetuese të Kosovës
Java e pestë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kosova nën administrimin ndërkombëtarë 2. Rezoluta 1244-efektet e saj 3. Tranzicioni Institucional 4. Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme 5. Deklarata e Pavarësisë (17 shkurt 2008)
Java e gjashtë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Propozimi për statusin final të Kosovës 2. Përmbajtja dhe struktura 3. Të drejtat e komuniteteve 4. Decentralizimi 5. Mbikëqyrja civile ndërkombëtare
Java e shtatë:	Vlerësimi i parë
Java e tetë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rast studimor
Java e nëntë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Liritë dhe të drejtat e njeriut 2. Raporti në mes të drejtës vendore dhe ndërkombëtare 3. Liritë dhe të drejtat politike 4. Liritë dhe të drejtat civile 5. Liritë dhe të drejtat ekonomike dhe kulturore 6. Të drejtat e Komuniteteve në Kushtetutën e Republikës së Kosovës
Java e dhjetë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kuvendi i Republikës së Kosovës 2. Kompetencat 3. Struktura 4. Procesi ligjvënës
Java e njëmbëdhjete:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Presidenti i Republikës së Kosovës

Praktika Institucionale	<ol style="list-style-type: none"> 2. Statusi 3. Kompetencat 4. Mënyra e zgjedhjes 5. Zëvendësimi 6. Imuniteti 7. Shkarkimi
Java e dymbëdhjetë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Qeveria e Republikës së Kosovës 2. Kompetencat 3. Kryeministri dhe roli i tij 4. Zgjedhja e Qeverisë 5. Pushimi i mandatit 6. Funksionimi 7. Votëbesimi dhe mosbesimi
Java e trembëdhjetë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sistemi i Drejtësisë 2. Gjykatat 3. Këshilli Gjyqësor 4. Këshilli Prokurorial 5. Gjykata Kushtetuese
Java e katërbëdhjetë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sektori i sigurisë në Republikën e Kosovës 2. Forca e Sigurisë së Kosovës 3. Agjencioni Kosovar për Inteligjencë 4. Këshilli i Sigurisë së Kosovës 5. Institucionet e Pavarura 6. Avokati i Popullit 7. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve 8. Dispozitat Kalimtare dhe tranzicionale të Kushtetutës së Republikës së Kosovës
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi i dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<ul style="list-style-type: none"> • <i>Personeli akademik duhet të reflektojë një standard të lartë të integritetit personal e profesional gjatë veprimtarisë së punës, duke zbatuar kuadrin ligjor përkatës, për t'u siguruar që procesi i punës kryhet në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme.</i> • <i>mësimdhënësi duhet t'i njoftojë studentët lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë vitit akademik dhe me kodin e mirësjelljes,</i> • <i>të bëhet realizimi i papenguar i ligjëratave në atë mënyrë që të respektohet orari i ligjëratave,</i> • <i>Kopjimi gjatë provimit dhe çdo lloj plagjiati janë rreptësisht të ndaluara.</i>